



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E ARSIMIT, RINISË DHE SPORTEVE
SEKTORI I ARSIMIT PARAUNIVERSITAR, RINISË DHE SPORTEVE

Nr. 3737 Prot.

Lezhë, më 25.03.2026

PROJEKT-VENDIM

PËR

PËR MIRATIMIN E AKORDIMIT TË FONDIT
PËR SHPËRBLIMIN E SPORTISTIT KAMPION KOMBËTAR

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 25, pika 4 dhe Vendimit nr.393 dt.18.07.2022 "Për Miratimin e Rregullores "Për Organizimin, Funkcionimin, Detyrat dhe Kompetencat e Administratës së Bashkisë Lezhë " neni 51, pika 3, VKM me Nr.789 datë 15.12.2021 "Për kriteret, mënyren e shpërblimit dhe trajtimin e sportistëve, që përfitojnë statusin e nivelit të lartë dhe trajnerëve të tyre " pika 16, Kryetari i Bashkisë Lezhë,

PROPOZON:

- I. Dhënien e shpërblimit në masën 100,000 lekë për sportistin Kampion Kombëtar Griseld Kodra për peshën 130 kg Greko – Roman (stil i lirë), në disiplinën e mundjes.
- II. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Lezhë.
- III. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI

Pjerin NDREU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nr. 3797/1 Prot.

Lezhë, më 25.03.2026

RELACION

PËR MIRATIMIN E AKORDIMIT TË FONDIT PËR SHPËRBLIMIN E SPORTISTIT KAMPION KOMBËTAR

KËSHILLIT BASHKIAK LEZHË

Bazuar në VKM Nr.789 datë 15.12.2021 “Për kriteret, mënyrën e shpërblimit dhe trajtimin e sportistëve, që përfitojnë statusin e nivelit të lartë dhe trajnerëve të tyre” pika 16 “Për shpërblimin financiar dhe trajtimin e sportistit të nivelit të lartë, për sportet individuale, apo të ekipit sportiv, për sportet kolektive, që kanë marrë vendin e parë në kampionatin kombëtar, organizata sportive përkatëse, që ushtron veprimtarinë në territorin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, paraqet kërkesën pranë saj. Të drejtën për të paraqitur kërkesë e ka edhe sportisti apo trajneri i tij. Kërkesa shoqërohet me rezultatin përfundimtar të federatës shqiptare të atij sporti, referuar kampionatit kombëtar, në të cilin sportisti apo ekipi sportiv ka marrë vendin e parë. Njësia e vetëqeverisjes vendore verifikon përmbushjen e kriteve pas marrjes së kërkesës. Fondet alokohen për organizatën sportive të sportistit/ekipit sportiv dhe trajnerit të tij, për llogari të këtyre të fundit.”

Duke ndjekur ecurinë e rezultatet e sporteve elitare përfaqësuese të Bashkisë Lezhë me emrin dhe logon “Besëlidhja” në disiplina të ndryshme, kemi veçuar sportistin kampion të kampionatit individual në Mundje, i cili është shpallur kampion individual në kategorinë e tij:

1- Griseld Kodra kampion individual disiplina MUNDJE – 130 kg në stilin Greko – Roman stil i lirë.

Specialistet e sportit në drejtorinë e ARS kanë ndjekur ecurinë e këtij sportisti në garat që ai ka zhvilluar me ekipin e tij përfaqësues sipas kalendarit vjetor të federates respektive, ku ka treguar nivel të lartë sportiv. Sportisti Griseld Kodra është model që ndjek rregullisht seancat stërvitore dhe ka treguar korrektësi në përgatitjet dhe pjesëmarrjen në të gjitha garat e zhvilluara në kategoritë respektive. Është sportist që trajtohet nga Bashkia Lezhë si kampion me trajtim ushqimor gjatë gjithë vitit, dhe është ambasador i Lezhës në aktivitete dhe turne Kombëtare.

K R Y E T A R I

Pjerin NDREU





Shoqata Kombëtare
Shumësporte
Lezhë

SHOQATA KOMBËTARE SHUMËSPORTE LEZHË

Nr. Prot. 8

Lezhë, më 12 / 03 / 2026

KËRKESË

Drejtuar: Bashkisë Lezhë, Drejtorisë Arsimit Rinisë dhe Sporteve

Lenda: Kërkesë për shpërblim për sportistin Griseld Kodra dhe trajnerin Altin Shtjefni të ekipit të mundjes "Besëlidhja"

Shoqata Kombëtare Shumësporte Lezhë, në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr. 184, datë 07.02.2025, të lidhur me Bashkinë Lezhë për mbështetjen e ekipeve sportive të shoqatës, paraqet pranë jush këtë kërkesë për vlerësimin dhe shpërblimin e sportistit të ekipit të mundjes "Besëlidhja", z. Griseld Kodra, dhe trajnerit të tij, z. Altin Shtjefni.

Sportisti Griseld Kodra ka arritur një rezultat të lartë duke u shpallur Kampion Kombëtar, pas fitimit të vendit të parë në Kampionatin Kombëtar për të rritur në stilin Greko-Roman (stili i lirë), të zhvilluar në Tiranë, më datë 28.09.2025.

Në mbështetje të dispozitave të Ligjit Nr. 79/2017 "Për Sportin", në lidhje me shpërblimin e sportistëve që shpallen kampionë në aktivitete kombëtare, kërkojmë miratimin e shpërblimeve si më poshtë:

1. Akordimin e shpërblimit financiar në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë për sportistin Griseld Kodra, për titullin Kampion Kombëtar.
2. Akordimin e shpërblimit për trajnerin Altin Shtjefni, në masën 40% të shumës së shpërblimit të sportistit, sipas parashikimeve të po këtij ligji.

Duke vlerësuar mbështetjen e vazhdueshme të Bashkisë Lezhë në zhvillimin e sportit, mbetemi në pritje të miratimit dhe mbështetjes suaj për realizimin e kësaj kërkesë.


Bashkëlidhur:

- **Fotokopja e noterizuar e diplomës** së vendit të parë të fituar nga sportisti Griseld Kodra.

Me respekt,

Shoqata Kombetare Shumesporte Lezhe

President
Sokol Ndoka
E deleguar
Gentiana Nicaj



Adresa: Lagja "Gurra", Pallati 150, Ap 12. Lezhe, Shqiperi
tel: +355692400505 email: shoqatashumesportelezhe@yahoo.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE SHKODËR
NOTER ADMIRA R. BORIÇI



V2025040750034432502

DATE 07/10/2025
NR REP 722



VËRTETIM NJËSIE ME ORIGINALIN

Sot, më datë 07/10/2025, para meje Noteres ADMIRA R. BORIÇI, Anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore SHKODËR, me zyrë në adresën QEMAL STAFA, BULEVARDI ZOGU I PARE, NR.2/102-N21, u paraqit personalisht:

KËRKUESI:

Ridvan Kodra, atësia Brahim, amësia Remzije, shtetas Shqiptar, lindur në Bushat, Shkodër dhe banues në VAU-DEJËS, me adresë Mucejanve 03380133; Nd. 19; H. 1; Bushat; Bushat; 4021; Vau-Dejës, lindur më 28/07/1966, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035643023 dhe nr. personal G60702069T, i cili kerkoi vertetimin me origjinalin te .

Diplome Fitues i Vendit te Pare ,Kampionati Kombetar per te Rritur FS-GR-WW Dokumenti Original, date 28/09/2025 lëshuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit në Shqiperi në emër të **GRISELD KODRA "BESELIDHJA"**.

Unë Noterja, pasi i bëra të qartë personit të mësipërm, përgjegjësini penale në rast paraqitje të dokumenti të rremë; bëra krahasimin e përmbajtjes së dokumentit origjinal me fotokopjen e paraqitur, mbi të cilat më rezulton se nuk janë bërë korrigjime, shtesa, fshirje, a shenja të tjera të dyshimta.


Si rrjedhim, në bazë të nenit 62, shkronja "i", nenit 129 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë"; Vërtetoj se fotokopja e dokumentit të paraqitur nga kërkuesi para meje Noteres, është e njëjtë me dokumentin origjinal.


Në zbatim të ligjit nr. 124/2024, datë 19/12/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të kërkuesit të këtij dokumenti, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTERE

PULLE TARIFE

ADMIRA R. BORIÇI





Diplomë



КАМПИОНАТИ КОМБЕТАР ПËР ТË РРИТУР

FS-GR-WW

FITUESI I VENDIT TË PARË

I jepet mundësit

GREISELD JODERA BESELIDHYA

Kategoria... 730 kg

Presidenti
Sahit Prizreni

TIRANË, 28.09.2025

Sekretar i Përgjithshëm

Isa Merka SHQIPËRI

